

VENDIM
Nr. 236, datë 27.3.2013

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 843, DATË 2.11.2012 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E SHTËPISË BOTUESE TË TEKSTEVE MËSIMORE
(BOTEM)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 4 e vendimit nr. 843, datë 2.11.2012 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

“4. Shtypja e teksteve të përcaktuara në pikën 3 të këtij vendimi realizohet nga Shtëpia Botuese e Teksteve Mësimore (BOTEM).”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 237, datë 27.3.2013

**PËR BASHKËRENDIMIN E VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT KOMBËTAR TË PUNËS
DHE KËSHILLIT KONSULTATIV TË BIZNESIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 200 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të neneve 1 e 2 të ligjit nr. 9607, datë 11.9.2006 “Për Këshillin Konsultativ të Biznesit” me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Këshilli Kombëtar i Punës dhe Këshilli Konsultativ i Biznesit bashkërendojnë punën për trajtimin e çështjeve që janë objekt i përbashkët i veprimtarisë së tyre.

2. Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës përgatisin mbledhje të përbashkëta të Këshillit Kombëtar të Punës dhe Këshillit Konsultativ të Biznesit, për çdo çështje që lidhet me politikën e zhvillimit ekonomik-shoqëror dhe në mënyrë të veçantë për:

- a) procesin e përgatitjes së Buxhetit të Shtetit dhe të paketës fiskale;
- b) politikën kombëtare të zhvillimit ekonomik e shoqëror;
- c) politikën e zhvillimit të tregtisë dhe të biznesit;
- ç) politikën e konkurrencës, mbikëqyrjes së tregut dhe mbrojtjes së konsumatorit;
- d) politikën e privatizimit.

3. Mbledhjet e përbashkëta të Këshillit Kombëtar të Punës dhe të Këshillit Konsultativ të



Biznesit bashkëdrejtohen nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

4. Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës informojnë Kryeministrin për konkluzionet dhe rekomandimet e dala nga mbledhjet e përbashkëta të Këshillit Kombëtar të Punës dhe Këshillit Konsultativ të Biznesit.

5. Bashkërendimi i veprimtarisë së Këshillit Kombëtar të Punës dhe të Këshillit Konsultativ të Biznesit, zhvillohet në vazhdimësi nëpërmjet shkëmbimit të informacionit, përgatitjes së materialeve për mbledhjen e këshillave përkatës dhe për mbledhjet e përbashkëta, dhe gjatë veprimtarisë së komisioneve të specializuara të Këshillit Kombëtar të Punës.

Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nxjerrin udhëzimet e nevojshme për mënyrën e bashkërendimit të veprimtarisë.

6. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr. 238, datë 27.3.2013

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR ZHVILLIMIN E NJË PROJEKTI KONCESIONAR NË ZONËN BREGDETARE “KALAJA E TURRËS”, KOMUNA SYNEJ, KAVAJË, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË “FINSEC” LTD

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 23 pika 3 shkronja “b” të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për zhvillimin e një projekti koncesionar në zonën bregdetare “Kalaja e Turrës”, Synej, Kavajë, i cili përfshin planifikimin, realizimin dhe përdorimin ekonomik të fshatrave turistike, hoteleve, komplekseve turistike, vilave, realizimin e një qendre SPA – kongrese - veprimtari kulturore, qendre sportive, fushë golfi, si dhe ndërtimin e infrastrukturës për këtë zonë, është Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

2. Projekti shtrihet në zonën gjeografike të përcaktuar sipas hartës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Miratimin e bonusit prej 5% (pesë për qind) të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën përzgjedhëse konkurruese (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “FINSEC” ltd.

4. Ngarkohet Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha